



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18.12.2025
Kodi i ZRRE-së: V_3008_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2785_10_25** i datës 29.10.2025;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 10.11.2025.

në seancën e mbajtur më datë 18.12.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **K. E.**, nga Komuna e Prishtinës, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2785_10_25 i datës 29.10.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 29.10.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2785_10_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit K. E., lidhur me kontestimin e faturës me nr. 02250DPR – 16683 e dt. 19.02.2025 dhe korrigjimit financiar me nr. 10734DPR – 16683 e dt. 10.04.2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konstatimet e DMK-së nuk qëndrojnë, sepse nuk jetojmë vazhdimisht në Kosovë, vetëm për pushime, për shkak edhe të moshës së shtyrë;
- Faturimi është i gabuar, dhe nuk pasqyron konsumin real të energjisë elektrike;
- Në muajin 10/2025 është ndërruar njehsori i energjisë elektrike;
- Kërkon korrigjimin e faturimit për periudhën e kontestuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Transaksionet e konsumatorit, Rrjedha e Energjisë Elektrike, Listat e Leximit, Raportin mbi kontrollimin-Pranimin e Grupit Matës nr. 0094563 të datës 13.05.2025, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore por që vërtetohet se për periudhat 11/2024 deri në periudhën 01/2025 kanë evidentuar se nuk kanë qasje në piken matëse të konsumatorit dhe se në këto periudha konsumatori është faturuar vetëm me taksa. Po ashtu edhe në periudha të shumta të me hershme lexuesit e KEDS-it kanë evidentuar se nuk kanë qasje në leximin e shpenzimeve mujore e që kjo është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në pronë të konsumatorit, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji. 2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm”*.

Bordi duke e pasur parasysh ankesën e konsumatorit për dyshim në matje të njehsorit të elektrik nr. 63608792 dhe mos inspektimi i njehsorit elektrik nga KEDS, ka kërkuar nga KESCO/KEDS që të bëhet inspektimi dhe shqyrtimi i njehsorit elektrik me pajisjen “ZERA”. Me datë 14.05.2025 KEDS ka ofruar procesverbalin nr. 0094563 të shqyrtimit të njehsorit nr. 63608792 ku është evidentuar se gabimi në matje të njehsorit elektrik është 0.20 %. Bordi i ka shqyrtuar të dhënat e evidentuara në procesverbal dhe konstaton se gabimi i evidentuar i matjes për njehsorin elektrik nr. 63608792 është brenda kufijve të lejuar të gabimit të përcaktuar me Kodin e Matjes së OSSH-së e që është $\pm 2.5\%$.

Bordi i ka shqyrtuar faturën nr. 02250DPR-16683 e datës 19.02.2025, krahasuar edhe me shpenzimet e konsumatorit konstaton se, ky faturim nuk paraqet shpenzim real mujor por që paraqet shpenzim të grumbulluar për periudhën 4 muajore, përkatësisht nëntor 2024 deri në periudhën shkurt 2025 për shkak se konsumatori në periudhën 11/12 2024 dhe 01/2025 është faturuar vetëm me taksa fikse.

Bordi e ka shqyrtuar Korrigjimin Financiar nr. 10734DPR-16683 të datës 10.04.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej -118.02€, në të cilin është evidentuar si vijon: *“Leximi i rregullt. Shpërndarje e kWh për periudhën 11/2024 deri 02/2025 duke u bazuar në ankesën e konsumatorit të datës 24.03.2025, leximet softuerike dhe rrjedhën e energjisë elektrike”*, dhe ka gjetur se, ky korrigjim është i saktë si dhe që KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike ku thuhet se: 3. *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*.

Duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e*



energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit K. E.,
- Arkivit të ZRrE-së